

Njoftim për përqendrim me të cilin ATLANTIC DROGA KOLINSKA, Industria ushqimore sh.p.k., Lubjanë, Republika e Sllovenisë do të fitojë kontroll mbi OSEM, Shoqëri për prodhim, tregti dhe shërbime sh.p.k., Murska Sobota, Republika e Sllovenisë

(lënda nr. 08-133/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 04.09.2025 është dorëzuar në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës njoftim për përqendrim me të cilin ATLANTIC DROGA KOLINSKA, Industria ushqimore sh.p.k., me seli në rr. Kolinska nr. 1, 1000 Lubjanë, Republika e Sllovenisë, synon të fitojë kontrollin e vetëm mbi OSEM, Shoqëri për prodhim, tregti dhe shërbime sh.p.k., Murska Sobota, me seli në rr. Čopova nr. 28, 9000 Murska Sobota, Republika e Sllovenisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste

ATLANTIC DROGA KOLINSKA, Industria ushqimore sh.p.k., është shoqëri tregtare veprimtaria e së cilës përfshin prodhimin e produkteve ushqimore, me fokus të veçantë në namaze delikatesash, pashtetë nga mishi dhe peshku, si edhe produkte të tjera ushqimore. Shoqëria vepron në tregjet e Evropës Juglindore dhe Qendrore, duke ofruar një gamë të gjerë produktesh për konsum të përditshëm dhe është një nga prodhuesit kryesorë të ushqimeve në Evropën Juglindore me marka të njohura si Barcaffè, Cockta, Donat dhe Argeta në segmentin e namazeve delikatesash.

ATLANTIC DROGA KOLINSKA, Industria ushqimore sh.p.k., është pjesë e grupit Atlantic Grupa d.d. Zagreb, aksionari shumicë i së cilës është Myberg d.o.o..

ATLANTIC DROGA KOLINSKA, Industria ushqimore sh.p.k., është në pronësi të plotë të Atlantic Trade, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për prodhim, tregti të brendshme dhe të jashtme, ndërmjetësim dhe agjenci..

Atlantic Trade është i pranishëm në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut si ortak me pjesëmarrje prej 75% në shoqërinë:

- Shoqëri për tregti dhe shërbime ATLANTIC TRADE SHKUP SHPK Ilinden, me veprimtari të regjistruar tregti me shumicë të sheqerit, çokollatës dhe ëmbëlsirave me bazë sheqeri.

Gjithashtu, Atlantic Trade është ortak i vetëm i shoqërisë Atlantic Grand SHPK. Shimanovci, e cila është e pranishme në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut si themelues i vetëm i shoqërisë:

- Shoqëri për prodhim, tregti dhe shërbime ATLANTIC GRAND SHPKNP import-eksport Shkup, me veprimtari të regjistruar tregti me shumicë të kafesë, çajit, kakaos dhe erëzave.

OSEM, Shoqëri për prodhim, tregti dhe shërbime sh.p.k., Murska Sobota, është shoqëri veprimtaria parësore e së cilës është prodhimi dhe shitja e mishit, namazeve të mishit dhe

përpunimeve të mishit. Në portofolin e saj, OSEM, Shoqëri për prodhim, tregti dhe shërbime sh.p.k., zotëron markën “Kekec” dhe një njësi prodhuese në Murska Sobota, Slloveni.

OSEM, Shoqëri për prodhim, tregti dhe shërbime sh.p.k., nuk ka degë dhe nuk është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe produktet e saj nuk janë të pranishme në treg.

Sipas parashtresës të njoftimit, tregu relevant për përqendrimin në fjalë mund të përcaktohet si treg i namazeve të kripura që përfshin namazet e mishit (përfshirë pashteta), namazet e peshkut (përfshirë pashteta), namazet bimore dhe namazet qumështore (të djathit dhe të bulmetit)] në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Bazuar në hetimin paraprak, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni u bën thirrje palëve të treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe ato duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

12.09.2025

Shkup